



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 1/2025 regjistër (JD)
Datë 21.05.2025

Nr. 2 i vendimit
Datë 23.09.2025

VENDIM

PËR MOSKALIMIN E ÇËSHTJES PËR SHQYRTIM NË SEANCË PLENARE

Kolegji i Shqyrtimit Paraparak, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Relator
Rezarta Schuetz	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

– mori në shqyrtim paraparak në dhomë këshillimi, më datë 23.09.2025, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 1, datë 21.05.2025, që i përket:

KËRKUES /ANKUES: Kledian Llaho, prokuror/magjistrat në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë
Inspektori i Lartë i Drejtësisë

BAZA LIGJORE: Neni 4, pika 3, neni 131, germa “f”, neni 134, pika 1, germa “i”, neni 140, pika 2, germa “a”, neni 179, pika 7 e Kushtetutës; Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Neni 5, pika 3, germa “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Nenet 27, 49, 71.3, 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenet 101, 102, 105, 107, 115 dhe 147.1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Neni 192.1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”.

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, pasi shqyrtoi në dhomë këshillimi kërkesën dhe aktet bashkëlidhur saj, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi/ankuesi Kledian Llaho, ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim “ILD”), me vendimin nr. {***}, datë 10.07.2024 ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurorit Kledian Llaho për shkeljen disiplinore të parashikuar në pikën 1, gjerat "ç", "d" dhe "dh" të nenit 102 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Hetimi disiplinor ka nisur bazuar në ankesën e regjistruar pranë ILD-së nga shtetasja E. S. ILD-ja me vendimin nr. {***}, datë 24.11.2023, ka vendosur verifikimin e ankesës duke administruar aktet dhe dokumentacionin pjesë përbërëse të dosjes së procedimit disiplinor. Në themel të këtij procedimi qëndrojnë veprimet e prokurorit Kledian Llaho që lidhen me zvarritjen e hetimit të një procedimi penal, në funksion të kallëzimit që ankuesja ka bërë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
3. Në përfundim të hetimit disiplinor ndaj magjistratit Kledian Llaho, ILD-ja i është drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”) me kërkesën nr. {***} prot., datë 10.12.2024 “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj prokurorit Kledian Llaho”, me propozimin për dhënien e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës” në masën 40 % të pagës për një afat njëvjeçar, parashikuar nga neni 105, pika 1, germa "c" dhe neni 108 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar” (në vijim ligji nr. 96/2016).
4. KLP-ja, me vendimin nr. 15, datë 30.01.2025 “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit Kledian Llaho, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”, ka vendosur: 1. *Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedimin disiplinor nr. {***} prot., datë 10.12.2024, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, gjerat "ç" e "d", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën Shqipërisë", i ndryshuar.* 2. *Dhënien e masës disiplinore "Vërejtje publike" për magjistratin Kledian Llaho, e parashikuar nga neni 105, pika 1, germa "b", dhe neni 107, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.* 3. *Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit Kledian Llaho, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes.* 4. *Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, brenda afatit të përcaktuar nga neni 50, pika 4 e ligjit*

nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar. 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

5. Kërkuesi/Ankuesi, pasi është njohur me vendimin e KLP-së nr. 15, datë 30.01.2025¹, ka paraqitur në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, (në vijim "Kolegji"), kërkesën/ankimin me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me ligjin nr. 96/2016, i ndryshuar të vendimit nr. 15, datë 30.01.2025. Kjo kërkesë është regjistruar në regjistrin e çështjeve të Juridiksionit Disiplinor (JD) me nr. 1/2025, datë 21.05.2025.
6. Krahas kërkesës për shfuqizimin e vendimit për dhënien e masës disiplinore, më datë 03.06.2025 ankuesi ka paraqitur kërkesë për marrjen e masës me karakter urgjent të pezullimit të efekteve të vendimit nr. 15, datë 30.01.2025 të KLP-së deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes (JD) nr. 1, datë 21.05.2025.

II. Vlerësimi i Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak

7. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, (në vijim "Kolegji Paraprak"), pas shqyrtimit të kërkesës/ankimit, vlerësoi të ndalej në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me: *i) juridiksionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit për shqyrtimin e kësaj çështje; dhe ii) verifikimin e plotësimin të kushteve për gjykimin e saj në seancë plenare*, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar, (në vijim "ligji nr. 8577/2000").
8. Lidhur me juridiksionin për gjykimin e kësaj çështjeje, Kolegji Paraprak identifikoi bazën ligjore të zbatueshme për shqyrtimin e çështjes (JD) nr. 1/2025, në kuadër të Juridiksionit Disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për të cilën konstatoi se:

8.1. Juridiksioni Disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit është një juridiksion kushtetues në zbatim të nenit 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon se: *Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*

¹ Këshilli i Lartë i Prokurorisë i ka dërguar vendimin nr. 15, datë 30.01.2025 z. Kledian Llaho dhe ILD-së nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 11.02.2025, e cila, referuar nënshkrimit në librin e dorëzimit (kopje e njëjësuar me vulë nga KLP-ja) rezulton se z. Kledian Llaho ka marrë në dorëzim këtë vendim me datë 14.02.2025. Kërkesa e z. Llaho për shfuqizimin e vendimit nr. 15, datë 30.01.2025 është regjistruar më datë 21.05.2025 në Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe rezulton të jetë depozituar brenda afatit 4 mujor të parashikuar në nenin 50, pika 4 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

8.2. Ky parashikim kushtetues është detajuar më tej në nenin 5, pika 3, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit [...] *Kolegji i Posaçëm i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*

8.3. Çështja e legjitimitetit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, germa "f" dhe 134, pika 1, germa "i" dhe pika 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, i ndryshuar, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

8.4. Ligji nr. 96/2016, në nenin 105, pika 1, rendit llojet e masave disiplinore të cilat mund të vendosen ndaj magjistratëve nga këshillat, që janë: a) vërejtje konfidenciale; b) vërejtje publike; c) ulje e përkohshme e pagës; ç) ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër; d) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitim të pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave; dh) shkarkim nga detyra.

8.5. KLP-ja në vendimin nr. 15, datë 30.01.2025 për caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistratit Kledian Llaho, është bazuar, ndër të tjera, edhe në nenin 149/a, pika 1, germa “b” të Kushtetutës, e cila parashikon: “1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi: [...]; b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve”.

8.6. Lidhur me ankimin ndaj masave disiplinore të përcaktuara në dispozitën ligjore më sipër, ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, neni 192, pika 1 parashikon se “*aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi prokurorët, ankimohen në Gjykatën Kushtetuese*”, funksionin e së cilës, për këtë qëllim, aktualisht e ushtron Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

8.7. Bazuar në sa më sipër, arrihet në përfundimin se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion *ratione materiae* për të shqyrtuar ankimet ndaj vendimeve për dhënien e masave disiplinore ndaj magjistratëve.

9. Në këndvështrim të verifikimit të plotësimit të kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 8577/2000, lidhur me kalimin për gjykim të ankimit në seancë plenare, Kolegji Paraprak konstaton se:

9.1. Ligji nr. 8577/2000, në kreun V rregullon çështjet lidhur me paraqitjen dhe shqyrtimin

paraprak të kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese. Ky kre, në drejtim të shqyrtimit paraprak, në nenin 27 të tij parashikon elementet që duhen verifikuar e që lidhen me aspektet formale të kërkesës dhe në nenin 31/a të këtij ligji, elementet, ekzistenca e të cilave çon Kolegjin Paraprak drejt vendimmarrjes për moskalimin e çështjes për gjykim në seancë plenare.

9.2. Në lidhje me verifikimin e të dhënave referuar kërkesave të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, ekzistenca e të cilave bën që kërkesa të mos kalojë për shqyrtim në seancë plenare, konstatohet sa vijon.

9.3. Lidhur me verifikimin nëse kërkesa e ankuesit plotëson elementet e pikës 2, germa “b” dhe “c”, të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, të cilat kërkojnë që kërkesa të paraqitet nga personi i legjitimuar, rezulton se kërkuesi/ankuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi ankimi është paraqitur nga vetë magjistrati Kledian Llaho.

9.4. Lidhur me verifikimin nëse kjo kërkesë plotëson kushtin sipas pikës 2, germa “ç”, të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, që ka të bëjë me afatin ligjor brenda të cilit duhet paraqitur kërkesa, rezulton se kërkuesi/ankuesi legjitimohet *ratione temporis*. Në pikën 4 të dispozitivit të vendimit nr. 15, datë 30.01.2025, të KLP-së, citohet se *kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese brenda afatit të përcaktuar nga neni 50, pika 4 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar*. KLP-ja i ka përcjellë vendimin e arsyetuar z. Kledian Llaho nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 11.02.2025 dhe referuar “Librit të dorëzimit” konfirmohet marrja në dorëzim e shkresës nr. {***}, datë 11.02.2025 më datë 14.02.2025, nënshkruar nga z. Kledian Llaho. Ankimi është dorëzuar në Kolegj, më datë 21.05.2025 dhe është regjistruar në të njëjtën datë me numër protokolli nr. {***} prot., brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 8577/2000.

9.5. Lidhur me kërkesën e pikës 2, germa “d”, të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, e cila kërkon të verifikohet nëse kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Kolegjit, siç është analizuar më sipër, vendimet e KLP-së për dhënien e masës disiplinore janë të ankueshëm vetëm pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për pasojë nuk ka pritshmëri për ezaurim të ndonjë mjeti tjetër ankimi.

9.6. Në drejtim të verifikimit të kushteve të parashikuara në nenin 31/a të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji Paraprak vlerëson të evidentojë parashikimin e pikës 2, germa “dh” të tij, sipas të cilës, moskalimi i çështjes në seancë plenare vendoset kur [...] *rivendosja në vend e së drejtës së shkelur nuk është më e mundur*.

9.7. Për sa më lart, Kolegji Paraprak vlerëson se për shqyrtimin e pretendimeve të kërkuesit/ankuesit duhet marrë në konsideratë fakti se, gjatë përgatitjes për shqyrtim të kësaj çështje, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit është gjykuar çështja (JR) nr. 11/2023, datë 10.03.2023, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 607, datë 22.12.2022, që lidhet me rivlerësimin kalimtar të subjektivit të rivlerësimit Kledian Llaho. Në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje, Kolegji, me

vendimin nr. 65, datë 01.08.2025 vendosi “Ndryshimin e vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kledian Llaho. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm. Si efekt i këtij vendimi magjistrati Kledian Llaho nuk e ushtron më detyrën e prokurorit si dhe ka humbur statusin e magjistratit, fakt ky që i zhvlerëson në thelb pretendimet e kërkesit/ankuesit për cenimin e së drejtës për ecurinë në karrierë. Për sa më sipër, Kolegji Paraprak vlerëson se, duke abstraguuar në lidhje me pretendimet e kërkesit/ankuesit për paligjshmërinë e vendimmarrjes së KLP-së si dhe ndikimin e kësaj vendimmarrjeje në ecurinë e tij për karrierë, aktualisht, ndodhur para faktit që magjistrati Kledian Llaho ka humbur statusin e magjistratit, pretendimi i tij për cenimin e të drejtës për ecurinë në karrierë ka mbetur pa objekt dhe nga shqyrtimi i kësaj çështjeje nga Kolegji nuk do të mund të rivendosej në vend e drejta që pretendohet nga ankuesi se është shkelur. Në këto rrethana rezulton e provuar situata e parashikuar nga neni 31/a, pika 2, “dh” e ligjit nr. 8755/2000.

9.8. Analizën e mësipërme Kolegji Paraprak e shikon të lidhur edhe me kriteret e përcaktuara në nenin 71/a, pika 1, gerrat “c” dhe “ç”, të ligjit nr. 8577/2000, që rregullon kushtet që duhet të përmbushë ankimi individual për tu pranuar për shqyrtimin nga Gjykata Kushtetuese - në këtë rast, nga Kolegji. Rezulton se kërkesa/ankimi i paraqitur nga magjistrati Kledian Llaho nuk plotëson të gjitha kërkesat e ligjit, pasi, siç u analizua më sipër, pasojat negative të pretenduara nga ankuesi nuk janë më të drejtpërdrejta dhe reale, në kushtet kur ankuesi nuk ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, shkak i cili ka sjellë si pasojë mbarimin e statusit të magjistratit dhe të karrierës së tij. Në këto kushte, kërkesa/ankimi i regjistruar si çështja (JD) nr. 1, datë 21.05.2025 ka mbetur pa objekt dhe gjithashtu shqyrtimi i saj nga Kolegji nuk do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur në kuptim të nenit 71/a, germa “ç” edhe nëse Kolegji do të vlerësonte se pretendimet e kërkesit/ankuesit janë të drejta e të bazuara në prova dhe ligj.

10. Në përmbledhje të sa më sipër analizuar, bazuar në përcaktimet e nenit 31/a, pika 2 germa “dh” dhe nenit 71/a, pika 1, gerrat “c” dhe “ç” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, Kolegji Paraprak vlerëson se ankimi nuk plotëson kriteret për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.
11. Gjithashtu, referuar sa më sipër, për të njëjtat arsye Kolegji Paraprak çmon se nuk mund të shqyrtohet as kërkesa e ankuesit nr. {***} prot., datë 03.06.2025, me objekt “Marrjen e masës me karakter urgjent, duke urdhëruar pezullimin e efekteve të vendimit nr. 15, datë 30.01.2025, deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes (JD) nr. 1/2025, datë 21.05.2025”.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, bazuar në nenin 31, nenin 31/a, pika 2, germa “dh”, si dhe nenin 71/a, pika 1, germa “c” dhe “ç” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Tiranë, më datë 23.09.2025.

ANËTARE

Albana Shtylla

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta Schuetz

nënshkrimi